

ORGANI SHQYRTUES I PROKURIMIT

Sipas Nenit 109 të Ligjit nr. 04/L-042 për Prokurimin Publik të Republikës së Kosovës, i ndryshuar dhe plotësuar me ligjin Nr. 04/L-237, ligjin Nr. 05/L-068 dhe ligjin Nr. 05/L-092

Një ankesë kundër: **KOMUNA E RAHOVECIT**

Për Aktivitetin e Prokurimit Nr. i AP:

Nr1 i prokurimit	623-26-2856-2-1-1
Nr i brendshëm	623-26-015-2-1-1

Sa i përket tenderit për **Hartimi i projekteve të ndryshme**

ANKESË

1. Identifikimi i ankuesit*

ENG IDEA SH.P.K.

(Shëno emrin e plotë të kompanisë suaj)

Brigada 123 p.n.

(Adresa)

Suhareke

(Vendi)

23000

(Kodi postar)

+38349111592

(Numri Telefonit)

n/a

(Numri i Faks-it)

Beqir Ramdani

(Emri i plotë i përfaqësuesit të kompanisë suaj)

engidea16@gmail.com

(Adresa elektronike)

30.05.2026

(Data e parashtrimit të kërkesës)


(Nënshkrimi dhe vula)



*Ankues do të thotë një palë e interesuar për parashtrim të ankesës.

¹ Të raportohet në çdo dokument apo kërkesë në lidhje me këtë aktivitet të prokurimit

2. Identifikimi i avokatit

Parashtruesi i ankesës mund ta parashtroj ankesën vetëm ose përmes avokatit të tij. Nëse ankesa parashtrohet përmes avokatit, atëherë duhet bashkangjitur autorizimin e përfaqësimit me PROKURË.

Shëno të dhënat si në vijim:

NUK APLIKOHET

(Emri i avokatit)

(Adresa e plotë)

(Numri i Telefonit)

(Numri i faks-it)

(Adresa elektronike)

(Data e parashtrimit të ankesës)

(Nënshkrimi dhe vula)

3. Të dhënat mbi aktivitetin e prokurimit

[Shëno një përshkrim të shkurtër lidhur me datën dhe vendin në të cilën është publikuar “ Njoftimi për Kontratë” apo “Njoftimi për konkurs të projektimit” dhe, nëse aplikohet “Njoftimi për dhënie të Kontratës”, “Njoftimi për Rezultatet e Konkursit të Projektimit” apo “Njoftimi për anulim të aktivitetit të prokurimit”, nëse aplikohet, afatin e fundit për dorëzimin e tenderit, datën dhe orën e fillimit të procesit për Hapjen e Tenderëve, si dhe kriteri për dhënie të kontratës]:

Data 29.04.2026, njoftimi për kontrate të publikuar
Date 19.05.2026 Kërkese për Rishqyrtim pran AK-se
Date 20.05,2026 Refuzim i kërkeses për Rishqyrtim

4. Procesi i Hapjes së tenderëve, nëse aplikohet

A keni marrë pjesë në procesin e Hapjes së tenderëve? Nëse po, specifikoni shkurtimisht ecurinë e procesit të Hapjes së Tenderëve.

Po

Jo

Nuk ka pase hapje publike të ofertave.

5. Njoftimi mbi Eliminimin e Tenderuesve, nëse aplikohet

A jeni njoftuar me shkrim lidhur me eliminimin tuaj nga pjesëmarrja e mëtutjeshme në aktivitetin e prokurimit ?

Po

Jo

6. Zgjidhja preliminare e mosmarrëveshjeve

A keni bërë kërkesë për rishqyrtim pranë AK lidhur me arsyet e eliminimit tuaj?

Po

Jo

Bashkëngjitur gjeni kopjen te vendimit te miratuar nga AK gjate kontekstit paraprak te zgjidhjes se mosmarrëveshjeve ne përputhje me nenin 108A te LPP-se.

7. Dispozitat e shkelura nga Autoriteti Kontraktues

Specifikoni dispozitën ose dispozitat e LPP-së që supozohet të jenë shkelur nga Autoriteti Kontraktues që nga momenti i publikimit të Njoftimit për Kontratë/Konkurs te Projektimit, dhe nëse aplikohet gjerë në përmbylljen e këtij aktiviteti të prokurimit me publikimin e Njoftimit për Dhënien e Kontratës apo Njoftimit për Rezultatet e Konkursit të Projektimit apo Njoftimit për Anulim.

Autoriteti Kontraktues ka shkelur dispozitat e LPP ne

Neni 1 Qëllimi

Neni 6 Ekonomiciteti dhe Efikasiteti

Neni 7 Barazia në Trajtim/ Jo- Diskriminimi

*** Sipas Nenit 118 të LPP, OSHP-ja do të kthej tarifën tuaj nëse ankesa aprovohet si e bazuar. OSHP-ja mund të kërkojë një gjobë shtesë deri në 5,000 Euro në rastet kur OSHP-ja konstaton që të gjitha apo cilado nga pretendimet e parashtruara në ankesë kanë qenë të rrejshme ose mashtruese.*

8. Deklaratë detale mbi faktet dhe argumentet

Përshkruani rrethanat faktike që përbëjnë supozimin për shkeljen e dispozitave të LPP-së. Ofroni deklaratë të qartë dhe të detajuara për faktet dhe argumentet të cilat mbështesin secilën bazë të ankesës tuaj.

Kundërshtim ndaj përgjigjes së Autoritetit Kontraktues

Operatori ekonomik konsideron se përgjigja e Autoritetit Kontraktues është e pabazuar, pasi arsyetimi i dhënë mbetet i përgjithshëm dhe deklarativ, pa ofruar analizë konkrete teknike apo profesionale që dëshmon domosdoshmërinë reale të kërkesave të kontestuara. Vetëm deklarimi se kërkesat sigurojnë “cilësi më të lartë”, “efikasitet” apo “saktësi” nuk përbën arsyetim profesional dhe proporcional sipas parimeve të prokurimit publik.

Ne si Operator ekonomik nuk kemi kundërshtuar nevojën që operatorët pjesëmarrës të posedojnë pajisje profesionale gjeodezike apo pajisje për rilevim dhe dokumentim teknik. Kundërshtimi ynë ka të bëjë ekskluzivisht me parametrat tepër specifikë dhe të avancuar teknike të kërkuar për dronin profesional dhe pajisjen SLAM LiDAR 3D Scanner, të cilët tejkalojnë nevojat reale të kontratës dhe kufizojnë konkurrencën në mënyrë të pajustifikuar.

AK pretendon se kërkesat për dron me minimum 60 MP dhe për SLAM LiDAR 3D Scanner janë të nevojshme për realizimin cilësor të kontratës, mirëpo nuk ka argumentuar konkretisht pse pikërisht këta parametra teknike janë të domosdoshëm dhe pse kontrata nuk mund të realizohet profesionalisht me pajisje tjera standarde profesionale që përdoren gjerësisht në praktikën e shërbimeve gjeodezike për nevojat e hartimit të projekteve.

Pretendimi i AK lidhur me kërkesat se nevojitet saktësi e lartë pasi kemi te bëjmë me “terrene komplekse” dhe “projekte infrastrukturore” nuk qëndron, duke pasur parasysh se natyra e projekteve në nivel komunal është kryesisht lokale dhe nuk kemi të bëjmë me projekte infrastrukturore strategjike kombëtare. Për rrjedhojë, AK **nuk ka dëshmuar** se projektet e specifikuar në paramasën dhe paralogarinë si dhe në përshkrimin teknik që janë objekt i kësaj kontrate kërkojnë pajisje ultra të specializuara dhe parametra teknike kaq të avancuar.

Po ashtu, pretendimi se rezolucioni minimum 60 MP është i domosdoshëm për ortofoto dhe modele 3D nuk është mbështetur me asnjë analizë profesionale. Në praktikën moderne të rivevimeve gjeodezike dhe fotogrametrike, cilësia dhe saktësia e rezultateve nuk varen vetëm nga rezolucioni i kamerës, por nga një sërë faktorësh teknikë dhe metodologjikë. Ekzistojnë pajisje profesionale me parametra më të ulët teknikë që përdoren rregullisht në projekte infrastrukturore dhe realizojnë rezultate profesionale. Po ashtu AK nuk ka arsytuar pse kërkohet SLAM LIDAR me parametrat e specifikuar dhe nuk ka sqaruar se cilat detyra konkrete të kontratës nuk mund të realizohen me pajisje tjera profesionale standarde të rivevimit.

Sa i përket arsytimit të dhënë nga AK ne lidhje me “përmbushjet e standardeve profesionale ndërkombëtare për rivevim, modelim dhe dokumentim teknik”, ky arsyetim është i përgjithshëm dhe nuk është mbështetur në ndonjë standard konkret të identifikuar apo të detajuar si kërkesë e dosjes së tenderit. Autoriteti nuk ka specifikuar se cilat standarde ndërkombëtare aplikohen në këtë rast, as nuk ka treguar lidhjen e drejtpërdrejtë ndërmjet atyre standardeve dhe kërkesave shumë specifike teknike për pajisjet e kontestuara. Vetëm referimi i përgjithshëm në “*standarde ndërkombëtare*” nuk përbën argument teknik të mjaftueshëm për të arsytuar dhe nuk mund të shërbejë si bazë për vendosjen e kërkesave të tilla kufizues dhe me parametra kaq të avancuar dhe të ngushtë teknik.

Në praktikën profesionale, përmbushja e standardeve ndërkombëtare në fushën e rivevimit dhe modelimit 3D nuk varet nga posedimi i pajisjeve me specifika të caktuara ekstreme, por nga metodologjia e punës, kalibrimi, saktësia e proceseve matëse dhe përpunimi i të dhënave. Për këtë arsye, shumë pajisje profesionale të pranura gjerësisht në tregun evropian dhe ndërkombëtar përdoren në projekte të ngjashme pa qenë e nevojshme përputhja me parametra kaq të ngushtë teknikë.

Arsyeja e dhënë nga AK se kërkesat e përcaktuara për pajisje janë “*kërkesa minimale*”, nuk qëndron pasi që këto specifikime nuk përbëjnë kërkesa minimale, por kërkesa të avancuara teknike që tejkalojnë nivelin e domosdoshëm për realizimin e projekteve komunale. Ato kufizojnë në mënyrë të panevojshme konkurrencën dhe nuk janë të arsytuar me nevojë konkrete teknike për kontratën.

Për më tepër, vetë niveli i kërkesave tregon se ato janë formuluar në bazë të performancës maksimale të pajisjeve të caktuara në treg, e jo në bazë të nevojës minimale funksionale për realizimin e shërbimeve komunale të projektimit dhe incizimit gjeodezik. Për rrjedhojë, këto kërkesa nuk mund të konsiderohen si “*minimale*”, por si kërkesa të **avancuara që kufizojnë konkurrencën** dhe rrisin në mënyrë të panevojshme pragun teknik për pjesëmarrje në procedurën e prokurimit.

Autoriteti Kontraktues nuk ka paraqitur asnjë analizë që dëshmon se objektivi i kontratës nuk mund të arrihet me pajisje standarde profesionale të përdorura gjerësisht në treg, duke e bërë kështu arsyetimin për “*kërkesa minimale*” të paargumentuar dhe jo bindës.

Fakti që AK deklaron se lejohen pajisje ekuivalente nuk e eliminon natyrën kufizuese të kriterëve, pasi parametrat e vendosur janë tepër specifikë dhe kufizojnë konkurrencën vetëm tek operatorët ekonomikë që posedojnë pajisje shumë të avancuara dhe me kosto të lartë.

Vendosja e kriterëve kaq specifike dhe të avancuara ndikon drejtpërdrejt edhe në koston financiare të procedurës së prokurimit, pasi kufizon pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë dhe rrit ndjeshëm koston e përgatitjes së ofertave. Po ashtu, përdorimi i pajisjeve me specifika kaq të avancuara ndikon edhe në rritjen e koston së realizimit të shërbimeve projektuese dhe gjeodezike, pa u dëshmuar se një nivel i tillë teknik është realisht i nevojshëm për natyrën e projekteve komunale objekt kontrate. Për pasojë, kriteret e tilla bien ndesh edhe me parimin e economicitetit dhe përdorimit efikas të parasë publike.

Për rrjedhojë, OE konsideron se AK nuk ka arritur të dëshmojë proporcionalitetin dhe domosdoshmërinë objektive të kërkesave të kontestuara nga ana jonë në kërkesën për rishqyrtim, andaj kërkojmë që kriteret teknike të rishikohen në mënyrë që të sigurohet konkurrencë e drejtë dhe trajtim i barabartë i operatorëve ekonomikë.

Në vazhdim po i paraqesim pretendimet ankimore për kontestimin e pajisjeve të kërkuara në dosjen e tenderit:

AK, KOMUNA E RAHOVECIT me date 19.05.2026 ka pergaditur dosjen per nevoja te sherbimeve profesionale te procedures se prokurimit me titull: **Hartimi i projekteve të ndryshme**, me numer prokurim: **623-26-2856-2-1-1**. Ne, ndermarrja ENG IDEA SH.P.K e themeluar ne vitin 2010 kemi zhvilluar aktivitein tone vetem ne sherbime profesionale Projektim, Mbikqyrje dhe konsulence profesionale ne fushen e arkitektures e ndertimtarise. Per 16 vite ne kemi punesuar eksperte dhe inxh. te fushave te inxhinieris duke realizuar Hartim te projekteve te natyrave te ndryshme dhe shume te rendesishem per shume institucione ne Republiken e Kosove e me gjere. Kjo procedure e prokurimit eshte analizuar me shume kujdes, nga e cila analize rezulton se kerkesat e paraqitura ne kete dosje jane ne shperputhje me qëllimin e procedures si teresi e ne veqanti bene perjashtimin nga konkurenca pjesen dermuese te ndermarrjeve projektuese perfshi ndermarrjen tone.

Do t'i paraqesim shqetesimet tona dhe pikat per te cilat ne vleresojme se jane kerkesa me qellim te eliminimit te konkurences apo favorizimi i drejteperdrejte te vetem nje Operatori ekonomik qe posedon, paisjet dhe softwerët e kërkuar ne kete dosje.

Kërkesat mbi mundesite teknike dhe/ose profesionale pika 9.1 & 9.2

Kërkesa 5 - Operatori ekonomik duhet të ketë Një (1) DRON profesional i dedikuar për inspektim, monitorim apo rilevim gjeodezik, i pajisur me kamerë digjitale, me rezolucion jo më pak se 60 megapixel. Droni duhet të ketë mundësinë e matjes me PPK (post processing kinematic) dhe softuerin e procesimit PPK. Duhet të prezantohet aprovimimi valid nga AAC (Autoriteti i Aviacionit Civil) për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit;

Dëshmia 5: Për pajisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete origjinale ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit, për inxhinierin të paraqitet certifikata e lëshuar nga AAC për operim të dronit dhe duhet të prezantohet aprovimimi nga AAC për inxhinierin për operimin e dronit të prezantuar. Të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i Dronit, për dronin dhe kamerën;

Argumentim juridik dhe profesional për Kërkesën 5

Lidhur me Kërkesën 5 “Operatori ekonomik duhet të ketë një dron profesional me minimum 60 MP, PPK, softuer PPK dhe operator të certifikuar nga AAC” Kjo kërkesë është qartësisht joproporcionale, diskriminuese dhe në kundërshtim me parimet themelore të prokurimit publik, për këto arsye:

1. Shkelja e parimit të proporcionalitetit

Sipas parimeve të Ligjit për Prokurimin Publik në Kosovë, autoriteti kontraktues ka obligim që kriteret teknike dhe profesionale të jenë në lidhje të drejtpërdrejtë me objektin e kontratës, të jenë proporcionale me natyrën dhe kompleksitetin e kontratës, dhe të mos kufizojnë konkurrencën pa arsye objektive.

Në rastin konkret objekti i kontratës është hartimi i projekteve në nivel komunal, ndërsa kërkohet pajisje e nivelit të avancuar të fotogrametrisë profesionale dhe ortofotografisë precize. Një dron me kamerë minimum 60 MP, sistem PPK, softuer profesional PPK, nuk përbën standard të nevojshëm e aq me pak të domosdoshëm për projektim ne nivelin komunal.

Për projektim të zakonshëm komunal rrugë lokale, trotuare, kanalizime, objekte publike, infrastrukturë urbane, mjaftojnë incizime standarde, GPS RTK konvencional, apo ortofoto ekzistuese.

Autoriteti kontraktues nuk ka asnje arsye te argumentuar teknikisht pse nevojitet rezolucion minimum 60 MP, pse nuk mjafton dron standard profesional, pse kërkohet PPK, dhe si ndikon kjo drejtpërdrejt në cilësinë e projektimit.

Kjo e bën kriterin arbitrar dhe disproporcional.

2. Specifikim teknik i orientuar drejt pajisjeve të caktuara

Kërkesa minimum 60 MP, PPK, softuer PPK kombinuar së bashku, praktikisht orienton tenderin drejt një numri shumë të kufizuar modelesh dhe operatorësh ekonomikë.

Sipas rregullave të prokurimit public nuk lejohen specifikime teknike që favorizojnë prodhues, marka apo teknologji të caktuara, përveç rasteve kur kjo është objektivisht e domosdoshme dhe e arsyetuar.

Në këtë rast nuk ekziston asnjë arsyetim profesional që cilësia e projektit komunal varet nga kamera 60 MP, apo nga posedimi i teknologjisë PPK.

Kjo përbën kufizim artificial të konkurrencës.

3. Kërkesë që lidhet me shërbime fotogrametrike dhe jo projektim

Teknologjia PPK përdoret kryesisht për ortofoto precize, hartografi, rievime topografike të avancuara, modelim të terrenit, matje gjeodezike me precizion shumë të lartë.

Ndërsa objekti i kontratës është hartim projektesh. Kjo tregon mungesë të lidhjes logjike ndërmjet pajisjes së kërkuar dhe rezultatit të kontratës.

Pra, kërkesa është vendosur artificialisht dhe jo mbi nevojë reale të projektimit.

Kërkesa 8: Operatori ekonomik duhet të ketë Një (1) PAISJE GJEODEZIKE SLAM LIDAR 3D SCANNER SYSTEM me RTK dhe PPK të integruar, minimum 640k pika second, option me 2 kamera, me minimum 48mpx, me të gjitha pajisjet përcjellëse;

Dëshmia 8: Për pajisjen të prezantohet dokumenti i pronësis (DUD doganor apo fature blerje) ose në rast se OE nuk posedon pajisjet mbi pronësinë duhet te ofroj marrëveshjen për marrjen me qira te pajisjeve. Marrëveshja duhet te jete ne emër te këtij projekti me validitet të kohëzgjatjes të kësaj kontrate e nënshkruar dhe vulosur nga te dyja palët. Marrëveshja duhet te jete origjinale ne mes te qiradhënësit dhe qiramarrësit, dhe të prezantohet specifikacioni nga prodhuesi i pajisjeve;

Kërkesën 8 SLAM LiDAR 3D Scanner me RTK dhe PPK, minimum 640k pika/sekondë, 2 kamera minimum 48 MP

Kjo kërkesë është jashtëzakonisht e tepruar dhe në kundërshtim të drejtpërdrejtë me parimin e proporcionalitetit, konkurrencën e lirë, dhe standardet normale të projektimit komunal.

1. Pajisje që nuk përbën standard të projektimit komunal

SLAM LiDAR 3D Scanner është teknologji shumë e specializuar që përdoret kryesisht për BIM dhe Digital Twin, skanime industriale, tunele, miniera, objekte komplekse industriale, trashëgimi kulturore, modelime 3D me precizion të lartë.

Nuk ekziston praktikë standarde e projektimit komunal që kërkon LiDAR SLAM, 640,000 pika/sekondë, RTK + PPK, kamera 48 MP.

Për projektim komunal standard matjet klasike gjeodezike, GPS RTK standard, total station, janë plotësisht të mjaftueshme.

2. Kërkesë e panevojshme dhe diskriminuese

Kjo pajisje ka kosto shumë të lartë, përdoret nga kompani shumë specifike, dhe nuk përbën pajisje standarde të tregut për kompani projektuese.

Për pasojë eliminohen operatorët ekonomikë të zakonshëm, favorizohen kompani të caktuara që posedojnë pajisje ultra-specializuese, krijohet barrierë artificiale për konkurrencë.

Kjo bie ndesh me trajtimin e barabartë, konkurrencën efektive, dhe ekonomicitetin në prokurim publik.

3. Specifikime tepër të detajuara që tregojnë favorizim

Kërkesat si minimum 640k pika/sec, 2 kamera, minimum 48 MP, RTK dhe PPK të integruar, janë specifikime të nivelit të katalogut teknik të prodhuesve.

Në praktikën e prokurimit public specifikime kaq të detajuara konsiderohen indikator favorizimi, sidomos kur nuk justifikohen me nevojë funksionale, nuk lidhen me rezultat konkret të kontratës.

Autoriteti kontraktues nuk ka dhënë asnjë analizë teknike pse duhen 640k pika/sec, pse kërkohet SLAM, pse duhet 48 MP, dhe si ndikojnë këto në cilësinë e projektit komunal.

4. Mungesa e lidhjes me standardet profesionale të projektimit

Asnjë standard normal i projektimit komunal urban, arkitektonik, infrastrukturor, rrugor, nuk e përcakton posedimin e SLAM LiDAR si kusht minimal profesional.

Standardet e projektimit kërkojnë staf profesional, licenca, përvojë, dhe matje adekuate, por jo posedim të teknologjisë ultra të avancuar të skanimit 3D.

Përfundim juridik dhe profesional

Kërkesat 5 dhe 8 nuk janë proporcionale me objektin e kontratës, nuk kanë lidhje direkte me cilësinë e projektimit komunal, tejkalojnë nevojat reale të kontratës, kufizojnë konkurrencën, dhe favorizojnë operatorë ekonomikë të caktuar.

Për pasojë, këto kritere janë në kundërshtim me parimin e proporcionalitetit, trajtimin e barabartë të operatorëve ekonomikë, mosdiskriminimin, dhe sigurimin e konkurrencës efektive në prokurim publik.

Mos reagimi i institucioneve relevante në raste të tilla është duke krijuar praktika jo të mira dhe të dëmshme për bizneset dhe ndërmarrjet profesionale, të cilat ndër vite kanë dhënë kontribut të rëndësishëm në ofrimin e shërbimeve profesionale dhe në realizimin e objekteve e projekteve me rëndësi të veçantë për Republikën e Kosovës.

Gjithashtu, kërkesa për pajisje të tilla të avancuara kufizon konkurrencën dhe ndikon drejtperdrejt në mundësinë që operatorët ekonomikë të ofrojnë alternativat e duhura për realizimin e projektit, duke siguruar që kërkesa për pajisje të jetë e arsyeshme dhe në përputhje me parimet e LPP-se për konkurrencën të ndershme dhe barazi.

Kerkojme nga OSHP të merr parasysh ankesën tonë të vleresoj drejtë dhe të bazuar, të anulohet njoftimi AK dhe të kërkojë racionalizimin e kushteve për aplikim në këtë procedurë të prokurimit në përputhje me Ligjin dhe rregulloret e LPP-se. Për të njejtën do t'i drejtohem organëve gjegjëse – KRPP-se dhe APK-se dhe OIRK-se.

9. Dëmet materiale

Përshkruaj mënyrën se si shkelja e supozuar i ka shkaktuar ose kërcënohet t'i shkaktojë dëme materiale parashtruesit të ankesës, ne rast se përfshini pretendime për kompensim.

Demet materiale janë te medha, duke patur parasysh se keto kritere demtojnë kompaninë tonë dhe pamundësojnë konkurimin në këtë procedurë të prokurimit, duke krijuar shpenzime enorme me synim që të arrihen kriteret e mbivlerësuara të kësaj procedurë për të konkuruar në fushën për të cilën tashmë në kemi arritur nivelin më të lartë të eksperiencës (15 vite pune në ofrimin e shërbimeve të projektimit).

10. Lista e dokumenteve (dëshmime) të bashkëngjitura

Nëse aplikohet, bashkëngjitni Ankesës dokumentet e renditura më poshtë:

- a) një kopje të publikimit të "Njoftimit për Kontratë" apo "Njoftimit për Konkurs të Projektimit.*
- b) një kopje të Kërkeses për Rishqyrtim*
- c) një kopje të Vendimit të AK se për refuzimin e Kërkeses për Rishqyrtim.*

****Sipas Nenit 111.2 të LPP, Parashtruesi i ankesës, origjinalin e ankesës do t'ia dorëzojë OSHP-së dhe njëkohësisht një kopje do t'ia dërgojë në mënyrën më të shpejtë të mundshme Autoritetit Kontraktues.*